

## KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Për: KOMUNA E MITROVICËS**

**Për Aktivitetin e Prokurimit: 642-19-6016-5-1-1 Nr i brendshëm 642/19/026/511**

**Sa i përket tenderit për: Rregullimi i shtratit të Lumit IBËR në Mitrovicë-bashkëfinancim me MIMPH.**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**“BAJRAKTARI”SH.P.K**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Maxhunaj Vushtrri*

*(Adresa)*

*Vushtrri*

*42000*

*(Vendi)(Kodi postar)*

*049-176-495*

*(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)*

*Mustaf Bajraktari*

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*bajraktarishpk@yahoo.com*

*(Adresa elektronike)*

*19.08.2019*

*(Data e parashtrimt të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vëla)*

**BAJRAKTARI**  
Shtetëri me p. gjegjësi të kufizuara  
Maxhunaj Vushtrri - KOSOVË  
Tel. / Fax: 028 672 760  
Tel. / Fax: bajraktarishpk@yahoo.com

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

---

*(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për Kontratë dt: 14.08.2019  
Data e fundit për dorëzim të ofertave 27.08.2019 14:00:00

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 21 i LPP-së  
Neni 27 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 18.9 i RRUOPP  
Neni 26.4 i RRUOPP  
Neni 44.9 i RRUOPP

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Fillimisht po ju rikujtojmë se ne kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë në lidhje me këtë projekt me rastin e ritenderimit nga ana juaj, për shkak të kriterëve favorizuese përkatësisht diskriminuese që i keni vendos.

Pas ankesës që kem parashtrur në OSHP, i njëjti institucion ka lëshuar vendimin me Nr. **326/18 i dt:09.08.2019 ku ka konstatuar se disa kriterë-kërkesa të vendosura nga ana juaj janë favorizuese/diskriminuese.**

Ju si AK, në FDT tek neni 9.1&9.2 në lidhje me kapacitetin teknik profesional keni kërkuar që projekt menaxheri të jetë inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, 10 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Hidroteknik), ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare keni kërkuar *“Operatori Ekonomik, duhet të ofroj dëshmi 1a.Kontrata e punës valide, të jetë në listen pagave me O.E.ose Grupin e O.E. në 6 muajt e fundit deri me datën e publikimit të njoftimit për kontratë.*

Po ashtu edhe për Udhëheqës të Punishtës keni kërkuar Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, 10 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Konstruktiv), ndërsa dëshminë e keni kërkuar njëjtë.

Kjo kërkesë bie në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant.

Në këtë rast dosja e tenderit nuk është përgatitur sipas nenit 27 të LPP-së dhe sipas nenit 18.9 sepse aty shkruan qartë që :

Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve.

Kjo kërkesë është shumë favorizuese/diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.

Pra ju si autoritet kontraktues në vend se të keni parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinj, ju përveç se nuk e keni marr parasysh këtë dispozitë, ju i keni diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në fushën e ndërtimit, e të cilët nuk do të thotë se duhet të kenë inxhinierë të këtyre fushave në listë të pagave në gjashtë mujorin e fundit, sepse është e pamundur që operatorët ekonomik ti kenë të gjitha kapacitete teknike dhe profesionale, prandaj janë të lejuara edhe parakontratat me staf të kualifikuar, madje lejohet të angazhohen edhe vetëm për një projekt dhe ky fakt nuk mund të ndikon absolutisht në realizmin e projekteve nga ana e operatorëve ekonomik.

Në këtë projekt, me rëndësi është të plotësohet përvoja e stafit, e inxhinierëve edhe pse edhe përvoja është kërkuar shumë e lartë, mirëpo kërkesa që këta inxhinierë të jenë në listë të pagave në gjashtë muajt e fundit nuk është asgjë tjetër dhe ska asnjë rëndësi tjetër për projektin, përveç tendencës për të përcaktuar fituesin qysh në start pra para ofertimit. Kërkojmë nga ana juaj që të largoni kërkesën që inxhinierët të jenë në listë të pagave në gjashtë mujorin e fundit.

I njëjti pretendim i joni është edhe për kërkesat me numra rendor 5, 6, 7, 8, 9 ku kërkohen që stafi të jetë në gjashtë muajt e fundit në listë të pagave. Këto kërkesa janë absurde.

Gjithashtu ka kërkesa tjera sa i përket aftësive teknike profesionale, ku p.sh është kërkuar Kamion kapacitet 15-20 m<sup>3</sup> kiper. Kjo kërkesë është kufizuese sepse mund të kërkohet si të shumë pajisje tjera vetëm minimumi, pra në këtë rast ka mundur të kërkohet minimumi 15 m<sup>3</sup>. Prandaj kërkojmë që mos të jetë kjo kërkesë në këtë mënyrë, por të përcaktohet minimumi i kërkuar.

Kjo procedurë e prokurimit është iniciuar me procedurë të përshpejtuar dhe afati i fundit për dorëzim të ofertave është parashikuar pas 12 ditëve, prandaj ky afat i shkurtër nuk mund të jetë afat korrekt dhe premtues për të përgatitur ofertat, sepse ky aktivitet i prokurimit është me vlerë të madhe dhe janë një mori dokumentesh dhe kërkesa që duhet plotësuar operatorët ekonomik, e që brenda kësaj periudhe faktikisht është e pamundur të dorëzohet një ofertë serioze dhe konkurruese.

Ju si autoritet kontraktues keni vepruar në kundërshtim me nenin 21 të RRUOPP, sepse shkurtimi i afateve kohore për vlera të mëdha nuk mund të jetë më pak se 15 ditë, ndërsa ju është dashur të keni parasysh kompleksitetin e kësaj lëndë dhe të lejoni afate më të gjata për ofertim. Prandaj kërkojmë nga ju që të zgjatni afatin e ofertimit, madje mos të lejoni afate vetëm me minimum por të krijoni hapësira dhe afate ligjore dhe korrekte të mjaftueshme për tu përgatitur operatorët ekonomik për ofertim. Kërkojmë që të zgjatet afati për ofertim me minimum 40 ditë.

Këto kërkesa duhet të ndryshohen substancialisht, nëse mendohet të keni një procedurë të rregullt, transparente dhe që të zhvillohet në mënyrë objektive dhe ligjore, përndryshe me këto kërkesa po dihet saktësisht se është përcaktuar paraprakisht fituesi i këtij tenderi.

Gjithashtu titullin e aktivitetit nuk e keni ndryshuar dhe nuk e keni shtuar fjalën ritenderim ashtu siç jeni të obliguar sipas 44.9 të RRUOPP ku shkruan "*Në qoftë se një procedurë e prokurimit është anuluar dhe AK ende dëshiron të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit përkatës, AK do të fillojë një procedurë të re të prokurimit pa ndryshuar numrin e prokurimit, por duke identifikuar atë me "Ri-tender".*

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, pasi që në Kosovë dihet se kush mund ti plotësojë këto kërkesa dhe dëshmi dokumentare, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe. *në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve.*

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

#### VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Bajraktari Shpk"  
**NDRYSHOHEN** kërkesat dhe afatet që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së dhe të zbatohen të gjitha dispozitat e LPP-së.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Demet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*